

Irlandë



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration



ÇFARË DUHET TË DINI RRETH RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E AZILIT DHE MIGRACIONIT

Lloji A

KËRKUESIT E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE



ALBANIAN

Përse po e merrni këtë broshurë?	3
Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe kush mund ta përfitojë atë?	3
Çfarë është Rregullorja për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit?	4
Çfarë është zhvendosja?	5
Të drejtat tuaja gjatë pritjes së vendimit për përcaktimin e vendit të BE+ që do të shqyrtojë kërkesën tuaj	6
Ku duhet të qëndroni gjatë pritjes së vendimit për përcaktimin e vendit të BE+ që do të shqyrtojë kërkesën tuaj?	8
Çfarë pritet nga ju në këtë proces?	8
Cilat dokumente duhet të paraqisni?	9
Përse keni detyrimin të jepni gjurmët e gishtave dhe të fotografoheni?	10
Cilat janë pasojat nëse nuk i përmbushni detyrimet tuaja?	11
Çfarë nënkupton ndalimi?	12
Si vendosin autoritetet se cili vend i BE+ do ta shqyrtojë kërkesën tuaj?	13
Ju mund të intervistoheni që të kuptohet se cili vend i BE+ do të shqyrtojë kërkesën tuaj	16
A zhvillohet një intervistë në të gjitha rastet?	18
Çfarë provash mund të paraqisni për të vërtetuar se keni familjarë në një vend tjetër të BE+?	19
Sa kohë merr procesi?	20
Çfarë ndodh nëse keni paraqitur tashmë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një vend tjetër të BE+?	21
Çfarë ndodh pasi të merret vendimi?	22
Çfarë duhet të dini rreth procedurës së ankimit (në rastet kur ka kombinim të ankimeve me efekt pezullues dhe në themel)	23
Çfarë duhet të dini rreth procedurës së ankimit (kur ankimet me efekt pezullues dhe ato në themel janë të ndara)	24
Cilat të dhëna personale do të mblidhen?	25
Cilat janë të drejtat tuaja lidhur me të dhënat personale?	25

➤ PËRSE PO E MERRNI KËTË BROSHURË?

Keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare (njohur gjithashtu si azil) në një nga 31 vendet e BE+. Kjo nënkupton që ju tashmë jeni një kërkues për mbrojtje ndërkombëtare. Ekziston mundësia që përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj të jetë një vend tjetër i BE+. Tashmë, ju jeni në pritje të këtij vendimi.

Është e rëndësishme të kuptoni mënyrën se si vendet e BE+ bashkëpunojnë pasi kjo mund të ndikojë te vendimi për vendin që do të shqyrtojë kërkesën tuaj.

Në këtë broshurë do të gjeni të gjithë informacionin e nevojshëm.

➤ ÇFARË ËSHTË MBROJTJA NDËRKOMBËTARE DHE KUSH MUND TA PËRFITOJË ATË?



Ju mund të keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në rast se nuk mund të ktheheni në vendin tuaj për shkak të frikës së persekutimit ose përballjes me rrezikun real ndaj dëmtimeve të rënda. Për shembull, kjo nënkupton se jeta ose liria juaj do të ishte në rrezik dhe autoritetet e vendit tuaj nuk do t'ju mbronin nga rreziku me të cilin përballeni.

Do të merrni më shumë informacion rreth mbrojtjes ndërkombëtare në një broshurë tjetër.

Aktualisht ndodheni në Irlandë i cili është një vend i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra.


➤ ÇFARË ËSHTË RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E AZILIT DHE MIGRACIONIT?



Vendet e BE+ kanë miratuar një ligj të përbashkët të quajtur Rregullorja për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit (AMMR). Ky ligj ndihmon në përcaktimin e vendit përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Ky ligj lejon gjithashtu që vendet e BE+ të ndihmojnë njëra-tjetrën në rastet kur një vend mbingarkohet me kërkesa në një periudhë kohore të caktuar.

Ju garantohet se një nga vendet e BE+ do ta shqyrtojë kërkesën tuaj, por nuk mund të zgjidhni se cili vend i BE+ do të jetë përgjegjës. Vendimi për përcaktimin e shtetit që do të shqyrtojë kërkesën tuaj do të merret sipas rregullave të ligjit të AMMR-së.

Nëse keni paqartësi lidhur me këtë broshurë, mund të pyesni nëpunësin e emigracionit.



Aktualisht, vendet e BE+ thjesht po vendosin se cili prej tyre është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

Nëse vendoset se përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj është një vend tjetër i BE+, ju do të transferoheni në atë vend.

➤ ÇFARË ËSHTË ZHVENDOSJA?



Një nga mënyrat me të cilat vendet evropiane mund ta ndihmojnë njëra-tjetrën është marrja përsipër e përgjegjësisë për:

- kërkuesit që qëndrojnë aktualisht në një vend tjetër evropian
- personat që kanë përfituar së fundi mbrojtje ndërkombëtare në një vend tjetër evropian.

Kjo njihet si zhvendosje.

Nëse jeni duke u shqyrtuar për zhvendosje, ju do të merrni një broshurë që përmban më shumë informacion rreth këtij procesi, duke përfshirë se cilat vende evropiane marrin pjesë në zhvendosje, me titull "**Çfarë duhet të dini rreth zhvendosjes**".

⚠ E RËNDËSISHME! Nëse jeni zgjedhur për zhvendosje, ju nuk mund të zgjidhni vendin në të cilin do të zhvendoseni.

▶ TË DREJTAT TUAJA GJATË PRITJES SË VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E VENDIT TË BE+ QË DO TË SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ



Nëse është hera e parë që paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, ju keni të drejtën të merrni **këshillim ligjor** falas. Ju mund t'u kërkonti këtë në çdo kohë autoriteteve.

Këshilltari ligjor do t'ju informojë për të drejtat tuaja dhe do t'ju mbështesë gjatë procesit. Nëse keni pajtuar tashmë një këshilltar ligjor me pagesë, autoritetet mund të mos ju ofrojnë këshillim ligjor falas. Këshillimi ligjor mund të ofrohet në grup, por këshilltari nuk do ta ndajë informacionin tuaj personal me personat e tjerë.

Ju mund të kërkonti këshilla ligjore duke kontaktuar autoritetet në Qendrën e Konventave City West përmes Shërbimeve Këshillimore të Bordit të Ndhmës Ligjore City West.



Nëse ju ndihmon të flisni më lehtësisht për situatën tuaj, ju mund të kërkonti që përkthyesi dhe nëpunësi i ngarkuar me trajtimin e rastit të jetë mashkull ose femër. Autoritetet do t'jua plotësojnë kërkesën aty ku është e mundur.



Ju keni gjithashtu të drejtën të kërkonti një përditësim rreth procedurës në të cilën do të përcaktohet vendi përgjegjës i BE+ për shqyrtimin e kërkesës suaj. Nëse dëshironi të kërkonti një përditësim, mund të kontaktoni autoritetet duke dërguar një email në [adresën contact@ipo.gov.ie](mailto:adresën_contact@ipo.gov.ie).



Ju keni të drejtën të viheni në kontakt dhe të komunikoni me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) në çdo hap të procedurës së azilit.

UNHCR-ja mbron interesat dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Detajet e kontaktit të UNHCR-së dhe informacioni mbi procedurën e azilit mund të gjenden në faqen e internetit të UNHCR-së: <https://help.unhcr.org/>.

Informacione të mëtejshme në lidhje me mbështetjen dhe shërbimet që do të përfitonit mund t'i gjeni në një broshurë të veçantë.

➤ KU DUHET TË QËNDRONI GJATË PRITJES SË VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E VENDIT TË BE+ QË DO TË SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ?



- Për momentin, keni detyrimin të qëndroni në këtë vend.
- Ju lejohet të udhëtoni në një vend tjetër të BE+ vetëm nëse autorizoheni për këtë nga autoritetet.
- Nëse autoritetet vendosin që kërkesa juaj do të shqyrtohet nga një vend tjetër i BE+, ato do të organizojnë udhëtimin tuaj drejt atij vendi.

➤ ÇFARË PRITET NGA JU NË KËTË PROCES?

Ju keni detyrimin:

- ✔ Të qëndroni në këtë vend gjatë regjistrimit të kërkesës suaj.
- ✔ Nëse ju është lëshuar vizë ose leje qëndrimi në të shkuarën, të paraqisni kërkesë për azil në vendin që jua ka lëshuar atë menjëherë pasi të mbërrini aty.
- ✔ Të paraqisni të gjitha dokumentet e identitetit që dispononi për të vërtetuar identitetin tuaj.
Të informoni autoritetet nëse ju është lëshuar në të shkuarën një dokument identiteti nga qeveria e vendit tuaj, edhe në rastet kur nuk e posedoni më atë.
- ✔ Të informoni autoritetet për çdo udhëtim që keni bërë drejt një vendi tjetër të BE+.
- ✔ Të informoni autoritetet nëse keni qëndruar pa leje në një vend të BE+.
- ✔ Të informoni autoritetet për çdo anëtar të rrethit të ngushtë familjar që keni në një vend tjetër të BE+.
- ❗ **E RËNDËSISHME!** Keni detyrimin ligjor që t'i nënshtroheni procesit të marrjes së gjurmëve të gishtave dhe fotografimit.

► CILAT DOKUMENTE DUHET TË PARAQISNI?

Ndani me autoritetet të gjitha dokumentet që dispononi lidhur me:



- identitetin tuaj (certifikata e lindjes, pasaporta, karta e identitetit)



- anëtarët e rrethit të ngushtë familjar në vendet e BE+ (dokumente zyrtare, prova që jeni në kontakt me ta)



- qëndrimet e mëparshme në vendet e BE+ (në bazë të lejes së qëndrimit, vizës ose për qëllime të pajisjes me diplomë)

Sigurojeni këtë informacion sa më shpejt të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, mund të identifikohet më shpejt vendi i BE+ përgjegjës për kërkesën tuaj.

➤ PËRSE KENI DETYRIMIN TË JEPNI GJURMËT E GISHTAVE DHE TË FOTOGRAFOHENI?



Autoritetet në këtë vend do t'ju marrin gjurmët e gishtave dhe do t'ju fotografojnë. Këto të dhëna do të transmetohen te baza evropiane e përbashkët e të dhënave Eurodac së bashku me informacionin rreth identitetit tuaj dhe informacione të tjera përkatëse.

Kjo bazë të dhënash përdoret nga të 31 vendet e BE+ që mund t'i përpunojnë të dhënat tuaja për të marrë informacione rreth jush. Në rast se ju lëvizni pa leje në një vend tjetër të BE+ dhe ju merren sërish gjurmët e gishtave, atëherë të gjitha të dhënat tuaja që ruhen në Eurodac do të aksesohen nga autoritetet e atij vendi.

Informacione të mëtejshme lidhur me bazën e të dhënave Eurodac jepen në një broshurë tjetër.



➤ CILAT JANË PASOJAT NËSE NUK I PËRMBUSHNI DETYRIMET TUAJA?



Nëse nuk bashkëpunoni me autoritetet, kjo do të sjellë pasoja negative të kërkesa juaj.

Nëse nuk i jepni gjurmët e gishtave, autoritetet mund të dalin në përfundimin se ju nuk jeni më i interesuar për të përfituar azil në Evropë. Ato do të ndërpresin shqyrtimin e kërkesës suaj, gjë që nënkupton se nuk gëzoni më të drejtën për të qëndruar në atë vend.

Nëse udhëtoni pa leje në një vend tjetër të BE+ ose paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një tjetër vend të BE+, gjasat janë që të riktheheni në vendin e BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

Nëse jeni i pranishëm në një vend të BE+ të ndryshëm nga vendi ku kërkohet të jeni të pranishëm, liria juaj mund të kufizohet dhe mund të merrni më pak mbështetje.



▶ ÇFARË NËNKUPTON NDALIMI?

Ndalimi nënkupton vendosjen tuaj në një ambient të posaçëm prej të cilit nuk mund të largoheni lirisht. Autoritetet duhet të kenë një arsye të vlefshme për t'ju ndaluar. Ato duhet të jenë të sigurt se nuk ka asnjë alternativë tjetër në rastin tuaj. Autoritetet do të vlerësojnë situatën tuaj personale përpara marrjes së vendimit. Arsyet e ndalimit mund të jenë, për shembull:



- aspekte të rëndësishme të kërkesës suaj për azil (për shembull identiteti juaj) nuk mund të verifikohen në mungesë të masës së ndalimit
- nuk keni respektuar detyrimin për të qëndruar në një vend specifik, ose ekziston rreziku që të largoheni sërisht dhe autoritetet të mos kenë mundësi t'ju kontaktojnë
- ju është dhënë një vendim për t'u transferuar në vendin e BE+ përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj për azil dhe ekziston rreziku që të largoheni përpara transferimit
- përbëni rrezik për sigurinë.

Nëse ndaloheni, ju mund ta ankimoni vendimin dhe të kërkonin ndihmë dhe përfaqësim ligjor pa pagesë.

⚠ E RËNDËSISHME! Rreziku që ju të ndaloheni në të ardhmen rritet në rast se udhëtoni pa leje në një vend tjetër të BE+.



SI VENDOSIN AUTORITETET SE CILI VEND I BE+ DO TA SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ?

Nëse është hera e parë që kërkon mbrojtje ndërkombëtare në një vend të BE+, ka disa arsye se përse një vend i caktuar i BE+ mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

1) Lidhjet familjare



Arsyeja e parë dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me faktin që një anëtar i rrethit të ngushtë familjar ka përfituar tashmë mbrojtje ndërkombëtare ose është duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në një vend tjetër të BE+ dhe ju duhet të bashkoheni me të përpara shqyrtimit të kërkesës suaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Do të konsiderohen anëtarë të rrethit të ngushtë familjar:

- bashkëshorti ose bashkëshortja juaj
- partneri/ja i/e pamartuar me të cilin/ën keni një marrëdhënie të qëndrueshme
- fëmija juaj (nën 18 vjeç dhe i pamartuar).



E RËNDËSISHME! Ju duhet të vërtetoni sa më shpejt të jetë e mundur se keni pasur një marrëdhënie me atë person përpara hyrjes suaj në rajonin e vendeve të BE+. Kjo periudhë mund të përfshijë rrugëtimin tuaj nga vendi i origjinës.

Nëse keni një anëtar të familjes që jeton në një vend tjetër të BE+, mënyra më e mirë për të dhënë informacion është duke plotësuar formularin e quajtur "modeli i gjurmimit të familjes" i cili do t'ju jepet së bashku me formularin e aplikimit. Nëse keni një anëtar të familjes që jeton në një vend tjetër të BE+ dhe nuk e keni marrë ende këtë formular, flisni me një zyrtar ose këshilltarin tuaj ligjor. Ata gjithashtu mund t'ju ndihmojnë të plotësoni formularin.

Mund të gjeni informacione më të detajuara mbi mundësinë e bashkimit me anëtarët e familjes në seksionin me titull "**Çfarë provash mund të paraqisni për të vërtetuar se keni familjarë në një vend tjetër të BE+?**"

2) Leja për të hyrë në një vend specifik të BE+

Një vend i BE+ mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, nëse:



- ju keni një vizë ose leje qëndrimi për atë vend të caktuar të BE+
- ju keni hyrë në atë vend të BE+ për shkak se keni të drejtën të hyni pa vizë pasi vendi juaj i origjinës ka një marrëveshje me atë vend.

3) Diploma ose kualifikimi arsimor



- Ju keni marrë një diplomë ose kualifikim pas studimeve që i keni ndjekur personalisht pranë një institucioni arsimor në një vend të BE+ për të paktën një vit akademik.

4) Hyrja e parregullt në një vend specifik të BE+

Një tjetër vend i BE+ mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, nëse:



- keni kaluar pa leje kufirin e jashtëm të një prej vendeve të BE+



- jeni shpëtuar në det nga autoritetet e një vendi të BE+ gjatë udhëtimit tuaj drejt Evropës



- keni paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në zonën e transitit të një aeroporti në një prej vendeve të BE+.

5) Bashkimi i kujdestarëve dhe familjarëve në varësi

Ju jeni nën varësinë e kujdesit të një anëtarit të familjes që ndodhet në një vend tjetër të BE+ ose keni një anëtar familjeje në një vend të BE+ që është nën varësinë e kujdesit tuaj.



Anëtarit të familjes që është nën varësi mund t'i nevojitet ndihmë për shkak të:

- shtatzënisë
- fëmijës së porsalindur
- sëmundjeve të rënda mendore ose fizike
- aftësive të kufizuara të rënda
- traumave të rënda psikologjike
- moshës së thyer.

Në rastet kur ka persona në varësi, ju duhet të provoni se jeni në gjendje të kujdeseni për personin në varësi ose që anëtar i familjes suaj është në gjendje të kujdeset për ju.

6) Motivet humane

Arsyeja e shqyrtimit të kërkesës suaj nga një vend specifik i BE+ mund të lidhet me një motiv humanitar. Kjo bazohet mbi shkaqet e mëposhtme:

- aspektet familjare
- aspektet sociale
- aspektet kulturore.

Një vendi tjetër të BE+ mund t'i kërkohej të shqyrtojë kërkesën tuaj në bazë të arsyeve të mësipërme, por vendimi përfundimtar i përket autoritetit të atij vendi.

➤ JU MUND TË INTERVISTOHENI QË TË KUPTOHET SE CILI VEND I BE+ DO TË SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ

Nëse kjo është hera juaj e parë që aplikoni për azil , por kërkesa juaj duhet të shqyrtohet në një vend tjetër të BE+ , autoritetet në Irlandë duhet të caktojnë një intervistë personale.

! E RËNDËSISHME! Kjo nuk do të jetë një intervistë për azil. Intervista synon të përcaktojë vendin e BE+ që duhet të shqyrtojë kërkesën tuaj.

Kjo intervistë ka katër synime kryesore:


- mbledhja e informacionit që do t'i ndihmojë autoritetet për të vendosur mbi vendin përgjegjës të BE+
- mundësimi i pyetjeve nga ana juaj rreth mënyrës së realizimit të procedurës për përcaktimin e vendit përgjegjës të BE+
- drejtimi i pyetjeve ndaj jush rreth faktit nëse ka arsye përse ju nuk duhet të transferoheni në një vend tjetër të BE+ ose përse duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend.

Intervista do të zhvillohet në një gjuhë që ju e kuptoni mirë. Nëse nuk flisni anglisht, një përkthyes do t'ju ndihmojë të komunikoni me autoritetet gjatë intervistës.



Asnjë nga informacionet që jepni nuk do të ndahet me qeverinë dhe as me autoritetet e vendit tuaj të origjinës.

Ju mund të bëni pyetje në rast se keni paqartësi gjatë intervistës. Pyetjet janë gjithmonë të mirëpritura për shkak se është shumë e rëndësishme që ju dhe nëpunësi të kuptoni çdo gjë.



Audioja e intervistës do të regjistrohet dhe do t'ju tregohet një përmbledhje me shkrim e asaj që u tha.

Ju mund të kërkonti korrigjimin e çdo informacioni të pasaktë, nëse mendoni se ka të tilla pasi të merrni përmbledhjen me shkrim të intervistës suaj personale, do të ketë mundësinë të korrigjojë çdo gabim dhe të konfirmojë saktësinë e tij.

Nëse është e nevojshme, ju mund të siguronit gjithsesi dokumente shtesë pas intervistës ose të cilësoni arsyet se përse nuk duhet të transferoheni në një vend tjetër të BE+.

Nëse keni ende informacione ose dokumente që nuk i keni dorëzuar akoma, ju duhet t'i dorëzoni ato pranë autoriteteve. Mund t'i paraqisni ato nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare ose me email në contact@ipo.gov.ie

A ZHVILLOHET NJË INTERVISTË NË TË GJITHA RASTET?

Nëse kjo është hera e parë që paraqisni kërkesë për azil, autoritetet mund të vendosin gjithsesi që të mos zhvillojnë një intervistë personale, nëse:

- dihet tashmë vendi i BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj
- ato kanë mjaftueshëm informacion për të vendosur se cili vend i BE+ është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj
- ju nuk jeni paraqitur në një intervistë të mëparshme pa lajmëruar autoritetet mbi arsyet e mospjesëmarrjes
- ju nuk keni respektuar detyrimin për të mbetur në kontakt me autoritetet.

Nëse nuk zhvillohet intervistë, ju mund të kërkonti që të kryhet. Nëse nëpunësit mendojnë se kanë tashmë mjaftueshëm informacion për të trajtuar rastin tuaj, ata mund ta refuzojnë këtë kërkesë me kusht që të arsyetojnë moszhvillimin e intervistës.

▶ ÇFARË PROVASH MUND TË PARAQISNI PËR TË VËRTETUAR SE KENI FAMILJARË NË NJË VEND TJETËR TË BE+?

Mënyra më e mirë për të dhënë informacion mbi anëtarët e familjes është përmes plotësimit të formularit " **modeli i gjurmimit të familjes** ".

Gjithashtu, siguroni çdo dokument zyrtar qeveritar që mund të vërtetojë marrëdhënien tuaj. Ju mund të paraqisni gjithashtu lloje të tjera provash, si p.sh. provat që tregojnë se keni mbetur në kontakt me anëtarin e familjes, ku përfshihen fotografitë, emaillet ose mesazhet me tekst.



Nëse nuk keni prova që vërtetojnë marrëdhënien tuaj, autoritetet mund t'ju kërkojnë të bëni një test ADN-je për të provuar lidhjen tuaj familjare.

Ju mund të bashkoheni me anëtarin e familjes suaj vetëm nëse të dy deklaroni me shkrim se dëshironi të bashkoheni. Ju duhet të përpiqeni, sipas mundësisë, që ta siguroni këtë dokument në gjuhën angleze.

Filloni ta përgatisni këtë informacion sa më shpejt të jetë e mundur.



Ju mund të kërkonit ndihmë nga një këshilltar ligjor nëse keni pyetje të mëtejshme ose nevojë për këshilla mbi procesin e bashkimit familjar mund të kërkonit ndihmë nga një përfaqësues.

Nëse keni anëtarë të familjes në një vend tjetër të BE+, por keni humbur kontaktet me ta, ka organizata që mund t'ju ndihmojnë t'i gjeni.

Mund të kontaktoni këto organizata duke përdorur informacionin më poshtë: Kryqi i Kuq Irlandez ofron një gamë mbështetjesh për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare. Shihni [Gjeni Familjen e Zhdukur - Kryqi i Kuq Irlandez](#) për informacion mbi gjurmimin e familjes.

SA KOHË MERR PROCESI?



Komunikimi mes vendeve zgjat zakonisht nga **1 muaj e gjysmë** deri në **3 muaj**, por ky komunikim **mund të zgjasë më shumë** në varësi të rastit tuaj.



Nëse një vend tjetër i BE+ konfirmon se do të shqyrtojë kërkesën tuaj, ju do të transferoheni **brenda 6 muajve** nga data e pranimit të kërkesës për transferimin tuaj.



Nëse kërkesa u bë për shkak se keni një anëtar të familjes në një vend tjetër të BE+, transferimi do të **trajtohet me prioritet**.



Nëse jeni **ndaluar aktualisht ose do të ndaloheni në të ardhmen**, rasti juaj do të **trajtohet me urgjencë**. Transferimi juaj duhet të organizohet brenda **5 javëve**. Nëse transferimi nuk kryhet brenda 5 javëve, do t'ju hiqet masa e ndalimit. Megjithatë, transferimi juaj do të organizohet gjithsesi **brenda 6 muajve** nga data e pranimit të kërkesës nga vendi i BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

Nëse ndodheni në burg për kryerjen e një krimi, afati kohor për transferimin mund të **zgjatet deri në 1 vit**.



! E RËNDËSISHME! Nëse largoheni, fshiheni ose nuk bashkëpunoni me autoritetet lidhur me organizimin e transferimit, **afati kohor për transferimin mund të zgjatet deri në 3 vjet**.

ÇFARË NDODH NËSE KENI PARAQITUR TASHMË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË NJË VEND TJETËR TË BE+?

Ju lejoheni të paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vetëm në një vend të BE+. Nëse keni paraqitur tashmë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një vend tjetër të BE+, ju do të riktheheni në vendin e BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

Nëse ka informacion që tregon se një vend tjetër i BE+ është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, këtij vendi do t'i dërgohet një njoftim. Nëse ai vend i BE+ konfirmon se do të shqyrtojë kërkesën tuaj, do t'ju jepet një **vendim transferimi** që parashikon vendin e BE+ në të cilin do të transferoheni.

Nëse kjo nuk është hera e parë që paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, ose nëse një tjetër vend i BE+ është vendosur tashmë si përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, autoritetet mund të mos e zhvillojnë intervistën personale me ju.

Megjithatë, ju do të keni mundësinë të shpjegoni arsyet se përse nuk duhet të transferoheni në atë vend ose përse duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend.

Ju mund ta jepni këtë informacion nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare ose me email në adresën contact@ipo.gov.ie.

➤ ÇFARË NDODH PASI TË MERRET VENDIMI?

Nëse ju jepet një vendim transferimi për të lëvizur drejt një vendi tjetër të BE+, disa nga të drejtat tuaja do të anulohen, si p.sh.:

- nuk do të përfitonit më aq shumë shërbime dhe shumë lloje mbështetjeje
- nuk do t'ju lejohet të punoni apo të ndiqni kurse.



Transferimi duhet të kryhet brenda 6 muajve nga data e konfirmimit apo pranimit për shqyrtimin e kërkesës suaj nga ana e vendit të BE+.

Nëse jeni ndaluar, rasti juaj do të trajtohet me urgjencë. Transferimi juaj duhet të organizohet brenda 5 javëve. Nëse transferimi nuk kryhet brenda 5 javëve, do t'ju hiqet masa e ndalimit.

Transferimi do të kryhet gjithsesi brenda 6 muajve nga data e konfirmimit apo pranimit për shqyrtimin e kërkesës suaj nga ana e vendit të BE+.

Nëse ndodhëni në burg për kryerjen e një krimi, afati kohor për transferimin mund të zgjatet deri në 1 vit.

❗ E RËNDËSISHME! Nëse largoheni ose nuk bashkëpunoni me autoritetet, afati kohor për transferimin mund të zgjatet deri në 3 vjet.

▶ ÇFARË NDODH NËSE NUK JENI DAKORD ME VENDIMIN E TRANSFERIMIT?



Nëse vendoset se përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj është një vend tjetër i BE+, do t'ju jepet një **vendim transferimi**. Ky vendim do t'ju informojë për vendin në të cilin do të transferoheni.

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit. Mund të paraqisni një apel. Kur apeloni një vendim, Tribunali për Apelime për Azilin dhe Kthimet, do të marrë vendimin përfundimtar

Ka vetëm tri arsye për ankimimin e një vendimi transferimi:

- ju pretendoni se transferimi në atë vend të BE+ do të binte ndesh me të drejtat e njeriut
- ka informacione të reja që nuk ishin të disponueshme në momentin e vendimit të transferimit, të cilat mund të ndikojnë në ky i fundit
- ju keni familjarë në një vend tjetër të BE+ me të cilët duhet të bashkoheni.

Nëse nuk keni mundësi për të pajtuar një këshilltar ligjor personal, do t'ju sigurohet një pa pagesë për t'ju ndihmuar me ankimimin.



Ju do të asistoheni gjatë gjithë procesit nga një përkthyes që flet një gjuhë që ju mund ta kuptoni.



ÇFARË DUHET TË DINI RRETH ANKIMIMIT KUR KA KOMBINIM TË ANKIMIMEVE ME EFEKT PEZULLUES DHE NË THEMEL

Në vendimin e transferimit që do të merrni shpjegohet afati, vendi dhe mënyra e depozitimit të ankimit.

Ju duhet të paraqisni arsyen ose arsyet se përse nuk jeni dakord me vendimin për t'ju transferuar në një vend tjetër të BE+.

Gjithashtu, duhet të jepni arsyen ose arsyet se përse nuk duhet të transferoheni drejt vendit të BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj ndërkohë që ankimi juaj është në pritje.

Fillimisht, tribunali do të vendosë brenda **1 muaji** nëse mund të qëndroni në këtë vend teksa prisni për rezultatin e ankimit. Një gjë e tillë njihet si ankimi me efekt pezullues.

Nëse tribunali vendos se nuk mund të qëndroni në këtë vend teksa prisni për rezultatin e ankimit, ju do të transferoheni drejt vendit të BE+ që është konsideruar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj ndërkohë që ankimi juaj është në pritje.

Nëse tribunali vendos që ju duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend ndërsa shqyrtohet ankesa juaj, ata do t'ju kërkojnë të jepni arsyen ose arsyet pse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit. Tribunali do të përpiqet më pas t'ju japë një vendim brenda **1 muaji** nga vendimi i apelimit me efekt pezullues.

Nëse ankimi juaj refuzohet, ju do të transferoheni në vendin e BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj. Transferimi duhet të kryhet brenda 6 muajve nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës.

Nëse jeni ndaluar aktualisht ose do të ndaloheni në të ardhmen, rasti juaj do të trajtohet me urgjencë. Transferimi juaj duhet të organizohet brenda 5 javëve. Nëse transferimi nuk kryhet brenda 5 javëve, do t'ju hiqet masa e ndalimit. Megjithatë, transferimi juaj do të organizohet gjithsesi brenda 6 muajve nga data e pranimit të kërkesës nga vendi i BE+ përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

E RËNDËSISHME! Ju duhet të bashkëpunoni me autoritetet dhe të udhëtoni drejt vendit të BE+ që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj.

➤ CILAT TË DHËNA PERSONALE DO TË MBLIDHEN?



Nëpunësit në vendin e BE+ ku po qëndroni do të mbledhin informacione të caktuara, duke përfshirë sa më poshtë:

- Të dhënat tuaja personale dhe ato të anëtarëve të familjes që udhëtojnë me ju (emri, shtetësia, datëlindja dhe vendlindja). Ata do t'ju pyesin nëse keni përdorur më parë emra apo të dhëna të ndryshme.
 - Informacioni mbi dokumentet tuaja të identitetit dhe të udhëtimit.
- Çdo informacion tjetër që mund të konfirmojë identitetin tuaj, si p.sh. gjurmët e gishtave.
 - Të dhënat mbi çdo anëtar të familjes që qëndron në një vend tjetër të BE+, si p.sh. të dhënat e tyre personale, hera e fundit që keni qenë në kontakt, vendndodhja dhe statusi i tyre ligjor.
 - Të dhënat rreth çdo dokumenti që keni, i cili ju ka lejuar të jetoni në një vend të BE+, sipas rastit.
 - Informacioni rreth dokumenteve që tregojnë se keni studiuar në një vend të BE+ për më shumë se një vit.
 - Informacioni mbi vendet përmes të cilave keni udhëtuar për të mbërritur në këtë vend.
 - Rrethanat tuaja personale.
 - Datat e kërkesave të mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare dhe rezultati i tyre, nëse ka të tilla.

➤ CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA LIDHUR ME TË DHËNAT PERSONALE?

Ju keni të drejtën të aksesoni çdo të dhënë që u keni siguruar autoriteteve.

Nëse besoni se ndonjë e dhënë personale është e pasaktë ose është përpunuar në mënyrë të paligjshme, ju mund të kërkonti akses në të dhënat tuaja personale duke kontaktuar kontrolluesin e të dhënave për të kërkuar korrigjimin e të dhënave të pasakta ose fshirjen e të dhënave të përpunuara në mënyrë të paligjshme.

Mund të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave në këtë vend, Në adresën: Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare, Shërbimi i Shpërndarjes së Imigracionit, 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2, D02 ND99 ose në adresën contact@ipo.gov.ie.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë shërben vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë broshurë nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.